

Ligjërata 4

SHPENZIMET DHE TË ARDHURAT

Prof.as. Avdullah Hoti

- ➔ Në këtë ligjëratë do të njiheni me:
 - ➔ *Konceptin e Shpenzimeve dhe të Ardhurave*
 - ➔ *Multiplikatorin e Shpenzimeve*
 - ➔ *Multiplikatorin e Politikës Fiskale*
 - ➔ *Multiplikatorin e Ekonomisë së Hapur*

SHPENZIMET AGREAGATE DHE GDP REAL: INVESTIMET DHE KURSIMI

➔ Në thelb, modelet makroekonomike, klasike dhe kejniane (neoklasike & neokejniane) synojn të shpjegojnë kushtet e ekuilibrit makroekonomik si dhe faktorët që përcaktojnë atë.

➔ Modeli Klasik:

GDP aktual përcaktohet, si në periudha afatshkurtra ashtu edhe në periudha afatgjata nga produkti potencial. Manipulimi nga qeveria me elementet e shpenzimeve agregate do të ndryshonte (sipas kësaj pikëpamje) jo në nivelin e produktit aktual por vetëm nivelin e përgjithshëm të çmimeve.

SHPENZIMET AGREAGATE DHE GDP REAL: INVESTIMET DHE KURSIMI

⇒ Modeli Kejnsian:

Mundësia e ndikimit në përmasat e produktit aktual të ekuilibrit me anë të ndikimit në elementet e ndryshëm të shpenzimeve agregate:

→ Modelet:

Të ardhura - Shpenzime (konsum + investime)

Kursim - Investime

...SHPENZIMET AGREAGATE DHE GDP REAL: INVESTIMET DHE KURSIMI

⇒ Supozimet:

- 1. Pagat dhe çmimet supozohen fikse: prodhuesit do të përgjigjen me sasinë e prodhuar por jo edhe me ndryshimin e çmimeve**
- 2. Abstrahohet nga tregu i parave**
- 3. Konsumi (C) dhe kursimet (S) janë të lidhura pozitivisht me të ardhurat dhe për thjeshtësi këto lidhje supozohen si lineare**
- 4. Investimet (I) dhe shpenzimet qeveritare (G) supozohen të pavarura (nga të ardhurat)**
- 5. Taksat të pavarura nga variablat ekonomike**
- 6. Eksportet janë autonome, ndërsa importet të varura nga të ardhurat**
- 7. Abstrahohet rritja ekonomike – modeli operon vetëm në periudha afatshkurtra.**

...SHPENZIMET AGREAGATE DHE GDP REAL: INVESTIMET DHE KURSIMI

Sipas modelit të ardhurat – shpenzimet. ekuilibri makroekonomik arrihet kur:


Figura 16.1: Përcaktimi i GDP me mënyrën të ardhura-shpenzime

$$PE = YE = AE$$

$$\text{Pra: } PE = AE = \text{GDP real}$$

Shënim:

Megjithatë, shpenzimet faktike nuk janë gjithmonë të barabarta me shpenzimet e planifikuara. Një ndër arsytet e këtij mosbarazimi është ndryshimi i inventarit të firmave. Firmat mund të përfundojnë me shtesa apo pakësimi të padëshiruar inventari.



Për çdo nivel prodhimi në të majtë të nivelit të ekuilibrit q^* , $PE > AE$ dhe GDP do të rritet drejt nivelit q^* . Për çdo nivel të $GDP > q^*$, $PE < AE$ dhe GDP do të pakësohet derisa të barazohet me q^* . Pra ekuilibri në pikën E është një ekuilibër i qëndrueshëm.

...SHPENZIMET AGREAGATE DHE GDP REAL: INVESTIMET DHE KURSIMI

Analiza sipas modelit kursim-investime

⇒ AD jepet si: $AD = C + I + G + X - Im$

⇒ AS ose të ardhurat totale: $Y = C + S + TA$

⇒ Në ekuilibër:

$$AD = Y$$

$$C + I + G + X - Im = C + S + TA$$

dhe


$$\begin{array}{l} \mathbf{I + G + X} \\ \underline{\text{(HYRJET)}} \end{array} = \begin{array}{l} \mathbf{S + TA + Im} \\ \underline{\text{(DALJET)}} \end{array} \quad (1)$$

...SHPENZIMET AGREAGATE DHE GDP REAL: INVESTIMET DHE KURSIMI

- ⇒ Nëse lëmë mënjanë G , X , Im , dhe TA
- ⇒ Nën kushtet e tilla barazimi (1) do të merr formën:
 $I = S$ → Ekuilibri (2)

- ⇒ Shenim:
 $S = f(YD)$
 $I = \bar{I}$

Figura 16.2: Përcaktimi i GDP së ekuilibrit me mënyrën $I = S$



MULTIPLIKATORI I SHPENZIMEVE

- ⇒ Përkufizimi:
Një ndryshim fillestar në shpenzimet autonome të planifikuara shkakton një varg ndryshimeve, të shumëzuar tek produkti i përgjithshëm i ekuilibrit.

Numri që luan rolin e shumëzuesit të efektit fillestar quhet MULTIPLIKATORI (s).

- ⇒ **Multiplikatori mund të llogaritet si raport i ndryshimit në GDP real me ndryshimin e shpenzimeve të pavarura:**

$$\text{MULTIPLIKATORI (s)} = \frac{\text{Ndryshimi në GDP real } (\Delta Y)}{\text{Ndryshimi në shp. e pavarura } (\Delta A)}$$

...MULTIPLIKATORI I SHPENZIMEVE: SHEMBULL PËR DISKUTIM

- ⇒ Të supozojmë se firmat rrisin shpenzimet e tyre për investime për 1 mil €
- ⇒ Gjithashtu supozojmë se $MPC=2/3$ (definimi i MPC)

Çfarë do të ndodh?

- ⇒ Investimet rrisin GDP për 1 mil € dhe këto janë të hyra për prodhuesit e makinave, të cilët i konsumojnë sipas MPC.....

1	x	1 milion €	=	1.00 milion €
2/3	x	1 milion €	=	0.66 milion €
$(2/3)^2$	x	1 milion €	=	0.44 milion €
$(2/3)^3$	x	1 milion €	=	0.29 milion €
...
$1/(1-2/3)$	x	1 milion €	=	3 milion €


- ⇒ Multiplikatori (s) = $1/(1-MPC)$
- ⇒ Pasi $1-MPC=MPS$, atëherë mund të shkruajmë $s=1/MPS$
- ⇒ $\Delta GDP=1/(1-MPC) \times \Delta I=1/MPS \times \Delta I$

...MULTIPLIKATORI I SHPENZIMEVE: SHEMBULL PËR DISKUTIM

- Paraqitni grafikisht multiplikatorin e shpenzimeve duke përdorur modelin I-S (Fig.16.3)
- GDP në ekuilibër është 45 mil E
- Investimet rriten nga 10 në 11 mil E. pra rriten me 1 mil E
- $MPC=4/5=0.8$
- Sipas formulës:

$$\begin{aligned}\Delta GDP &= 1/(1-MPC) \times \Delta I = \\ &= 1/(1-0.8) \times 1 \text{ mil} = \\ &= 5 \times 1 \text{ mil} = 5 \text{ mil}\end{aligned}$$


Figura 16.3: Multiplikatori i shpenzimeve



...MULTIPLIKATORI I POLITIKËS FISKALE

- ⇒ Politika fiskale konsiston në shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime: G , TA , TR
- ⇒ Vini re: $\uparrow G \Rightarrow \uparrow GDP$, por $\uparrow TA \Rightarrow \downarrow GDP$
- ⇒ Shembull: $PE = C + I + G$


Figura 16.4: Përcaktimi i produktit total të ekuilibrit me përfshirjen e shpenzimeve qeveritare



...MULTIPLIKATORI I POLITIKËS FISKALE

- Multiplikatori i shpenzimeve qeveritare tregon për sa rritet GDP kur G rriten me një njësi
- $S_g = 1/(1-MPC)$
- Shembull: G rritet me 100 njësi, $MPC = 4/5 = 0.8$
 $S_g = 1/(1-0.8) = 1/0.2 = 5$
GDP rritet për 5×100 njësi = 500 njësi

Figura 16.5: Multiplikatori i politikës fiskale



MULTIPLIKATORI I TAKSAVE

Taksat ndryshojnë të ardhurat e disponueshme

Multiplikatori i taksave ndryshon në dy pikëpamje nga multiplikatori i shpenzimeve:

- 1. shpreh lidhje negative në mes të ndryshimit të taksave dhe ndryshimit në GNP**
- 2. është më i vogël se multiplikatori i shpenzimeve. Shkaku qëndron tek efekti fillestar i ndryshimit të taksave në shpenzimet për konsum pra edhe në GDP**

Efektet sekondare: nuk ka ndryshime të theksuara dhe në përgjithësi mund të flasim për efekte të njëjta sekondare si në rastin e multiplikatorit të taksave dhe atë të shpenzimeve

...MULTIPLIKATORI I TAKSAVE

Si shprehet S_t ?

$$S_t = MPC \times S_e = MPC \times 1 / (1-MPC) = \\ = MPC / (1-MPC)$$

$$S_t < S_e$$

Shemull:

$$\Delta TA = -30 \text{ mil}, MPC = 2/3, G = \hat{G}.$$

Gjeni ΔGDP ?

$$\Delta YD = -\Delta TA = -(-30) = 30 \text{ mil}$$

$$\Delta GDP = S_t \times \Delta YD$$

$$S_t = MPC / (1-MPC) = (2/3) / (1-2/3) = 2$$

$$\Delta GDP = 2 \times 30 \text{ mil} = 60 \text{ mil}$$

...MULTIPLIKATORI I TAKSAVE

Cili eshte efekti neto i politikës fiskale?

❖ **Krahasohet efekti i rritjes se G me efektin e ndryshimit te TA:**

$$\begin{aligned} S_b &= S_g - S_t = \\ &= 1/(1-MPC) - MPC/(1-MPC) = \\ &= (1-MPC)/(1-MPC) = 1 \end{aligned}$$

...MULTIPLIKATORI I TAKSAVE

Multiplikatori varet nga MPC

↑ MPC => ↑ efekti i ndryshimit ne G apo I ne GDP

Por, rritja e MPC e zvogelon MPS, qe shpie ne zvogelimin e I (pasi I varen nga S, pra $I=S$)

Pra, ↑ MPC e rrit GDP drejtperdrejt, por e zvogelon gjithashtu ate permes zvogelimit te MPS

...MULTIPLIKATORI I TAKSAVE

Rritja e MPS => rritjen e S => rritjen e I = rritjen e GDP


Por, nderhyn efekti i kundert permes pakesimit te konsumit, prandaj GDP do te ulet

Ne kete model I jane te pavaruara nga te ardhurat (Y)

- cili do te ishte efekti i rritjes se MPS ne GDP?
- pasi I jane konstante, kemi efekt negativ

paradoksi i kursimit

Figura 16.6: Paradoksi i kursimit



MULTIPLIKATORI I EKONOMISË SË HAPUR

⇒ Vendet janë të lidhura në mes vete përmes
Ex dhe Im

⇒ Shpenzimet e brendshme:

$$PE = C + I + G$$

⇒ Pasi ju shtohet Ex dhe Im fitojmë
Shpenzimet e përgjithshme të planifikuara:


$$TPE = C + I + G + NX$$

⇒ Përfshirja e NX paraqitet në Figurën 16.7

MULTIPLIKATORI I EKONOMISË SË HAPUR

- ⇒ Ekuilibri arrihet në pikën E ku TPE pret vijën 45 shkallë
- ⇒ Në pikëprerjen e PE (C+I+G) dhe TPE (C+I+G+NX), eksporti=importin
- ⇒ Në të majtë të kësaj pike $X > Im$ (zgjerim ek.)
- ⇒ Në të djathtë të kësaj pike $X < Im$ (rënie ek.)
- ⇒ Kurba e TPE ka pjerrtësi më të vogël se kurba TE
 - ⇒ Pasi një pjesë e shpenzime shkon për importe

Figura 16.7: Përcaktimi i GDP së ekuilibrit në një ekonomi të hapur



MULTIPLIKATORI I EKONOMISË SË HAPUR

- ⇒ Prirja margjinale për importe (MPM) tregon rritje e importeve për çdo njësi shtesë të GDP-së.
- ⇒ MPM e zvogëlon pjerrtësinë e TPE
- ⇒ MPM zvogëlon multiplikatorin
 - ⇒ Pasi një pjesë e të ardhurave shkon për mallra importi
- ⇒ MPM paraqitet si:
$$S_o = 1 / \{(1-MPC)+MPM\} = 1 / (MPS+MPM)$$
- ⇒ Multiplikatori i ek. së hapur është më i vogël se multiplikatori i ek. së mbyllur

KUFIZIMET E MULTIPLIKATORIT

- I zbatueshëm në periudha afatshkurtra,
- I zbatueshëm në periudha recesioniste
- Lë mënjanë inflacionin
- Nuk merr parasysh efektin e parasë dhe të variablave tjerë ekonomik

Detyrë

- **Siguroni te dhëna per GDP dhe komponentat e e tij për periudhën 2001-2009:**
 - **Konsumi (C)**
 - **Investimet (I)**
 - **Shpenzimet Qeveritare (G)**
 - **Eksporti (Ex)**
 - **Importi (Im)**

- **Analizoni trendin e GDP dhe shpenzimeve qeveritare gjatë kësaj periudhe:**
 - **Për sa % është rritur GDP dhe G gjatë kësaj periudhe?**
 - **Llogaritni koeficientin e korelacionit në mes të GDP dhe G gjatë kësaj periudhe**

- **Jepni mendimin tuaj se cili ka qenë efekti i rritjes së G në GDP gjatë kësaj periudhe**